**URDHËR**
**Nr. 92, datë 30.4.2026**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 4.5.2026 deri më datë 8.5.2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
**Besfort Lamallari**